



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KUSHTETUESE**  
**УСТАВНИ СУД**  
**CONSTITUTIONAL COURT**

---

Prishtinë, 31 maj 2021  
Nr.ref.:RK 1801/21

## **VENDIM PËR REFUZIM TË KËRKESËS**

në

**rastin nr. KIo3/21**

Parashtrues

**Rrahim Ramadani**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit AC-I-15-0211-A0001 të  
Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme,  
të 3 shtatorit 2020**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare  
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar  
Bekim Sejdiu, gjyqtar  
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare  
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare  
Safet Hoxha, gjyqtar  
Radomir Laban, gjyqtar  
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe  
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Kërkesa është dorëzuar nga Rrahim Ramadani, me vendbanim në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi i kërkesës e kërkon vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit [AC-I-15-0211-A0001] të 3 shtatorit 2020, të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Apelit).

## **Objekti i çështjes**

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar. Parashtruesi i kërkesës nuk ka specifikuar se cilat të drejta dhe liri të garantuara me Kushtetutë pretendon se i janë shkelur përmes vendimit të kontestuar.

## **Baza juridike**

4. Kërkesa bazohet në paragrafin 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa Individuale] të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatë**

5. Më 8 janar 2021, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 18 janar 2021, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Safet Hoxha gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bekim Sejdiu (kryesues), Selvete Gërxhaliu-Krasniqi dhe Gresa Caka-Nimani (anëtare).
7. Më 22 janar 2021, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai që të dorëzojë në Gjykatë i) Aktgjykimin [DHPGJS,C-IV-13-1020] të 22 shtatorit 2015 të Kolegjit të Specializuar të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Specializuar) dhe ii) të sqarojë kërkesën e tij para Gjykatës.
8. Parashtruesi i kërkesës nuk i është përgjigjur kërkesës së Gjykatës.
9. Më 5 maj 2021, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës që të refuzojë kërkesën me procedurë të shkurtër.

## **Përmbledhja e fakteve**

10. Parashtruesi i kërkesës, në cilësinë e parashtruesit të kërkesës, parashtron për herë të pestë kërkesë në Gjykatë. Më parë ai parashtroi kërkesat KI 141/14, KI129/15, KI70/17 si dhe 17/20 kërkesë kjo e cila ende është në shqyrtim para Gjykatës. Megjithatë, në kërkesën e tanishme KI03/21, objekt i kontestuar është Aktgjykimin [AC-I-15-0211-A0001] i 3 shtatorit 2020, të Kolegjit të Apelit, i cili në kërkesat e sipërcekura nuk ishte objekt i shqyrtimit.

11. Bazuar në shkresat e lëndës, rezulton se parashtruesi i kërkesës dhe Rr.A, më 20 gusht 2007, i ishin drejtuar Agjencisë Kosovare të Privatizimit ( në tekstin e mëtejme: AKP) me kërkesë për shlyerjen e borxhit që kishte të bënte me kërkesën e tyre për kompensim në të holla, lidhur me pretendimin se në vitin 1989, e kishin bërë pagesën për një mall në vlerë prej 2.700 euro nga Ndërmarrja Shoqërore “19 Qershori” me seli në Podujevë, por të njëjtin asnjëherë nuk e kishin pranuar.
12. Më 30 maj 2013, Autoriteti i Likuidimit të AKP-së, përmes Vendimit [nr.PRNo28-0243], refuzoi kërkesën e Rr.A si të pavlefshme.
13. Më 26 qershor 2013, parashtruesi i kërkesës dhe Rr.A parashtruan padi në Kolegjin e Specializuar kundër Vendimit të lartpërmendur të Autoritetit të Likuidimit të AKP-së.
14. Më 22 shtator 2015, Kolegji i Specializuar përmes Aktgjykimit [C-Iv-13-1020] kishte refuzuar padinë me arsyetimin se Vendimi i lartpërmendur i Autoritetit të Likuidimit të AKP-së, ishte i drejtë dhe i bazuar në ligj dhe se kompensimi për borxhin të cilin parashtruesi i kërkesës dhe Rr.A e kërkojnë, bazuar në nenin 371 të Ligjit nr.29/1979 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, tashmë ishte parashkruar.
15. Më 19 gusht 2020, parashtruesi i kërkesës kërkoj nga Dhoma e Posaçme të Gjykatës Supreme, të kërkoj nga AKP sqarim për mos përfshirjen e parashtruesit të kërkesës në Vendimit [nr.PRNo28-0243], e Autoritetit të Likuidimit të AKP-së, të 30 majit 2013.
16. Më 21 gusht 2020, AKP sqaroi se ishte gabim teknik mos përfshirja e parashtruesit të kërkesës në Vendimin [nr.PRNo28-0243], e Autoritetit të Likuidimit të AKP-së, të 30 majit 2013, dhe se Vendimi i lartpërmendur i Autoritetit të Likuidimit të AKP-së i referohet edhe parashtruesit të kërkesës.
17. Në një datë të paspecifikuar parashtruesi i kërkesës dhe Rr.A paraqitën ankesë në Kolegjin e Apelit, kundër Aktgjykimit [C-Iv-13-1020] të Kolegjit të Specializuar, të 22 shtatorit 2015.
18. Më 3 shtator 2020, Kolegji i Apelit, përmes Aktgjykimit [AC-I-15-0211-A0001] refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe Rr.A dhe e vërtetoi Aktgjykimin [C-Iv-13-1020] të Kolegjit të Specializuar, të 22 shtatorit 2015, duke e konsideruar të njëjtin si të drejtë dhe të ligjshëm. Kolegji i Apelit në Aktgjykimin e tij arsyetoi se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe se parashtruesi i kërkesës nuk kishte ofruar asnjë provë të re me anë të së cilës do të dëshmonte se parashtruesi i kërkesës me kohë i ishte drejtuar organeve kompetente për realizimin e kësaj të drejte.

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

19. Parashtruesi i kërkesës para Gjykatës nuk ka specifikuar se cilat liri dhe të drejta të garantuara me Kushtetutë pretendon se i janë cenuar përmes vendimit të kontestuar.



20. Parashtruesi i kërkesës para Gjykatës thekson “ *Mendoj që shkelja e parë është pse qëllimisht veprohet për t’i dëmtuar të qytetarët të varfërit. Pronën time pse me keqpërdorë të gjitha institucionet. Unë vetëm një faturë kam tjetër dëshmi s’di çfarë dëshmie duhet kur e paguan mallin vetëm me faturë e dokumenton deri sa të marrësh mallin tënd kur e paguan*”.
21. Parashtruesi i kërkesës, në fund, kërkon nga Gjykata që “*të arrij të më kthen parat e miya që i kam pague fabrikës 15 qershori Podujevë*”.

### **Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës**

22. Gjykata së pari shqyrton nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.
23. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

*“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*

*[...]*

*7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”*

24. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë siç janë të përcaktuara me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet neneve 47 (Kërkesa individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

#### Neni 47 (Kërkesa individuale)

*“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.*

*2. Individ mund të ngrejë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”*

#### Neni 48 (Saktësimi i kërkesës)

*“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”*

Neni 49  
(Afatet)

*“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor [...].”*

25. Në kontekst të dispozitave të lartcekura, Gjykata thekson se bazuar në paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës, paragrafin 1 të nenit 47 dhe nenin 48 të Ligjit, përpos specifikimit të aktit konkret të autoritetit publik i cili kontestohet, palët janë gjithashtu të detyruara që të qartësojnë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendojnë se u janë cenuar. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata vëren që parashtruesi i kërkesës, përkundër kërkesës të Gjykatës për sqarim, nuk ka dorëzuar para Gjykatës dokumentacionin e kërkuar, bazuar në të cilin, kërkesa e tij para Gjykatës do të sqaronte në mënyrë adekuate edhe rrethanat faktike të rastit e edhe pretendimet e tij përkitazi me të drejtat dhe liritë themelore të cilat pretendon se i janë cenuar.
26. Në këtë kontekst, Gjykata rikujton se kërkesën e parashtruesit të kërkesës e kishte pranuar më 8 janar 2021. Duke marrë parasysh që kërkesa nuk ishte e kompletuar, në pajtim me paragrafin 4 të nenit 22 (Procedimi i kërkesës) të Ligjit dhe pikat (f) dhe (g) të paragrafit (2) të rregullit 32 (Parashtrimi i kërkesave dhe i përgjigjeve) të Rregullores së punës, Gjykata fillimisht kërkoi nga parashtruesi i kërkesës që në Gjykatë të dorëzojë Aktgjykimin [C-IV-13-1020] të 22 shtatorit 2015, të Kolegjit të Specializuar si dhe kërkoi nga parashtruesi i kërkesës që të sqarojë kërkesën e tij para Gjykatës. Parashtruesi i kërkesës, nuk iu është përgjigjur kërkesës së Gjykatës.
27. Në këtë aspekt, Gjykata i referohet paragrafit (5) të rregullit 35 të Rregullores së punës, i cili përcakton si në vijim:

Rregulli 35  
(Tërheqja, hedhja poshtë dhe refuzimi i kërkesës)

[...]

*“(5) Gjykata mund të vendosë të refuzojë një kërkesë me procedurë të shkurtër në qoftë se kërkesa është e paplotë ose e paqartë përkundër kërkesave të Gjykatës ndaj palës që të plotësojnë apo qartësojnë kërkesën.”*

[...]

28. Gjykata thekson se rregulli i lartcekur i Rregullores së punës, i mundëson Gjykatës që të refuzojë një kërkesë me procedurë të shkurtër nëse, ndër të tjera, kërkesa e një parashtruesi është e paplotë dhe e paqartë, përkundër kërkesave të Gjykatës për të plotësuar dhe qartësuar kërkesën përkatëse. Gjykata i është drejtuar parashtruesit të kërkesës me kërkesës për të plotësuar dhe për të qartësuar kërkesën e tij, pa sukses.
29. Gjykata rithekson se në rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me një kërkesë të parashtruesit të kërkesës për kompensimin e një borxhi në vlerë prej 2.7000 euro, kundër N.SH “19 Qershori” ku parashtruesi pretendon se në vitin 1989 kishte bërë pagesën për një mall dhe të njëjtin nuk e kishte marrë asnjëherë.



Parashtruesi i kërkesës fillimisht i ishte drejtuar AKP-së, e cila e kishte refuzuar kërkesën e tij. Më pas i ishte drejtuar Kolegjit të Specializuar me padi kundër vendimit të AKP-së dhe Kolegji i Specializuar kishte refuzuar ankesën si të pabazuar me arsyetimin se kërkesa tashmë ishte parashkruar. Pas ankesës së parashtruesit të kërkesës në Kolegjin e Apelit, ky i fundit refuzoi ankesën dhe e vërtetoi Aktgjykimin e Kolegjit të Specializuar.

30. Para Gjykatës, është dorëzuar vetëm Aktgjykimi [AC-I-15-0211-A0001] i 3 shtatorit 2020, i Kolegjit të Apelit, ndërsa, edhe përkundër kërkesës së Gjykatës të 22 janarit 2021, në Gjykatë nuk janë dorëzuar dokumentet e tjera relevante, përfshirë (i) Aktgjykimin [DHPGJS,C-IV-13-1020] të 22 shtatorit 2015, e Kolegjit të Specializuar; dhe (ii) parashtruesi i kërkesës nuk e ka sqaruar kërkesën para Gjykatës.
31. Gjykata rikujton se barra për të ndërtuar, sqaruar dhe plotësuar kërkesën bie mbi parashtruesit e kërkesës, të cilët kanë interes të drejtpërdrejtë në mënyrë që pohimet dhe pretendimet e tyre të adresohen në mënyrë efektive nga Gjykata. Në rastet kur parashtruesit e kërkesës nuk i përgjigjen kërkesave të Gjykatës për qartësimin dhe plotësimin e kërkesës, Gjykata, i refuzon këto kërkesa me procedurë të shkurtër. (Shih, ndër të tjera, rastet e Gjykatës KI90/20, me parashtrues *Arben Boletini*, Vendim për refuzimin e kërkesës, i 9 dhjetorit 2020, paragrafi 25; dhe rastet nr. KI78/20, KI79/20 dhe KI80/20, me parashtrues *Hilmi Aliu dhe të tjerët*, Vendim për refuzimin e kërkesës, i 7 dhjetorit 2020, paragrafi 33 dhe referencat e përdorura aty).
32. Në rrethana kur një kërkesë para Gjykatës është e paplotë ose e paqartë përkundër kërkesave të saj ndaj parashtruesit të kërkesës që të plotësojë apo qartësojë kërkesën, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit të kërkesës, nuk i përmbush kriteret procedurale për shqyrtim të mëtejshëm, për shkak se është e paplotë dhe e paqartë, siç është përcaktuar në paragrafin (5) të rregullit 35 të Rregullores së punës.
33. Prandaj dhe përfundimisht, në përputhje me rregullin 35 (5) të Rregullores së punës, kërkesa duhet të refuzohet me procedurë të shkurtër.

## PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenet 20, 47 e 48 të Ligjit dhe rregullin 35 (5) të Rregullores së punës, më 5 maj 2021, njëzëri

### VENDOS

- I. TË REFUZOJË kërkesën;
- II. T'UA KUMTOJË këtë Vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë Vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit;
- IV. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Gjyqtari raportues**

  
Safet Hoxha



**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

  
Arteta Rama-Hajrizi